

PIPERAZINE

Tableta – 250 mg
(Piperazinë adipat)

Lexojeni me kujdes këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletudhëzues:

1. Çfarë është Piperazine dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Piperazine
3. Si ta merrni Piperazine
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Piperazine
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË PIPERAZINE DHE PËRSE PËRDORET

Piperazina është një antihelmintik që vepron kundër askarideve (*Ascaris lumbricoides*) dhe enterobiazave (*Enterobius vermicularis*). Te askaridet, piperazina shkakton bllokim neuromuskulor që çon në paralizë muskulore të këtyre parazitëve, të cilët pastaj largohen me lehtësi nga pozicioni i tyre prej lëvizjeve të zorrëve dhe pastaj jashtëqiten me feçet. Tabletat Piperazine 250 mg ndikohen në trajtimin e askaridiazës dhe enterobiazës. Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Piperazine për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini përse ju është dhënë Piperazine.

2. PËRPARA SE TË MERRNI PIPERAZINE

Mos merrni Piperazine në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri ndaj piperazinës apo ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të tabletave Piperazine;
- vuani nga epilepsia;
- keni dëmtim të rëndë të funksionit të veshkave;
- keni dëmtim të funksionit të mëlçisë.

Tregoni kujdes të veçantë me Piperazine

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Piperazine në qoftë se:

- do të përdoret tek të sëmurët me dëmtim të funksionit të veshkave (nuk duhet përdorur kur dëmtimi është i rëndë);

- do të përdoret tek të sëmurët me sëmundje nervore;
- jeni shtatzënë.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Piperazine. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Piperazine në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.

- Efekti antihelmintik i piperazinës mund të antagonizohet nga piranteli.
- Ekziston mundësia e ndërveprimit të fenotiazinave me piperazinën.

Marrja e Piperazine me ushqim dhe pije

Nuk ka të dhëna për ndikimin e ushqimit dhe pijeve në farmakokinetikën e Piperazine.

Shtatzënia

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë. Është raportuar se piperazina është teratogjenike tek lepuit dhe janë raportuar raste të izoluar të keqformimeve fetale pas përdorimit të piperazinës tek njerëzit. Për këtë arsye, këshillohet të mos përdoret gjatë shtatzënisë dhe veçanërisht gjatë tremujorit të parë, përveç rasteve kur trajtimi me piperazinë është i domosdoshëm për nënën.

Ushqyerja me gji

Piperazina kalon në qumështin e gjirit. Nënata duhet të këshillohen që ta marrin barin pas dhënies së gjirit dhe më pas të mos e ushqejnë foshnjën me gji për 8 orë. Gjatë kësaj periudhe 8-orëshe ata duhet ta mbledhin dhe ta derdhin qumështin i cili do të sekretohet në oraret normale të ushqyerjes së foshnjës me gji.

3. SI TA MERRNI PIPERAZINE

Gjithmonë merreni Piperazine sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj. Në qoftë se ndjeni që efektet e Piperazine janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Tabletat duhet të gëlltiten me një gotë ujë (200 - 250 ml ujë).

Dozimi jepet si më poshtë:

Fëmijët deri në 1 vjeç: 200 mg, 2 – 3 herë në ditë;
Fëmijët nga 1 – 6 vjeç: 200 – 400 mg, 2 – 3 herë në ditë;

Fëmijët nga 6 – 15 vjeç: 400 – 500 mg, 2 – 3 herë në ditë;
Fëmijët mbi 15 vjeç dhe të rriturit: 500 mg, 3 herë në ditë.

Mjekimi vazhdohet për 1 javë rresht dhe piperazina zakonisht merret 2 orë para ushqimit. Në mjekimin me doza sulmi (sidomos në askaridiazë), në ditën e parë përdoren 100 mg piperazinë / kg peshë, 2 orë para ngrënies së darkës, por jo më shumë se 3 g (d.m.th 12 tableta). E njëjta dozë përdoret edhe ditën e dytë esëll (1 orë para ngrënies së mëngjesit). Zakonisht këshillohet që mjekimi me Piperazine të përsëritet pas 6 javësh në askaridiazë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Piperazine

Në qoftë se keni marrë më shumë Piperazine se sasia që duhet të merrni, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të merrni Piperazine

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a). Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bar, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Piperazine mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Piperazine tolerohet mirë në dozat e rekomanduara. Njoftoni mjekun tuaj për efektet anësore të mëposhtme që mund t'ju shfaqen:

- nauze, të vjella, kolika, diarre, dhimbje abdominale, dhimbje koke;
- reaksione alergjike (përfshirë urtikarien, rashet kutane, bronkospazmat e më rrallë sindromën *Stevens-Johnson* dhe angioedemën);
- më rrallë përshkruhen marrje mendsh, çorientim muskular, përgjumje, debulesë, ataksi, parestezi, konfuzion mendor, lëvizje koreiforme, tremor, kontraksione mioklonike, konvulsione dhe humbje të refleksëve tek të sëmurët me çrregullime neurologjike ose renale;
- shqetësime të përkohshme vizuale si shikim i turbullt dhe formim katarakti, megjithëse ky i fundit ende nuk është provuar.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj. Kur shfaqet ndonjë nga efektet anësore të mësipërme, mjekimi me Piperazine duhet ndërprerë dhe ju duhet të këshilloheni me mjekun ose me farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI PIPERAZINE

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Piperazine pas datës së skadencës. Ruajeni nën temperaturën 25°C!
Ruajeni në paketimin original për ta mbrojtur nga drita dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Piperazine

Lënda aktive është piperazinë adipat.
Çdo tabletë përmban 250 mg piperazinë adipat.
Lëndët ndihmëse janë amidon, celulozë mikrokristallore, xhelatinë, glikolat natriumi i amidonit, stearat magnezit.

Përmbajtja e paketimit

Kuti me 30 tableta.

Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit dhe Prodhuesi:



PROFARMA Sh.a.
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2023.

